

'Laboratori i debatit mbi integrimin European në auditorët universitarë' – Edicioni I

Edicioni I i "[Laboratori i debatit mbi integrimin european në auditorët universitare](#)", u zbatua nga [Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim](#) (SCiDEV) me mbështetjen e [Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë](#) (OSFA) përgjatë muajve Tetor 2019 – Qershor 2020 në qytetet Tiranë dhe Durrës.

Në përfundim të projektit, 104 të rinj ([13 skuadra debatuese](#)), studentë të shkencave sociale, ekonomike, juridike dhe humane janë përfitues direkt. Ata kanë marrë përvojën e debatit të strukturuar përmes mentorimit, debatit, kërkimit dhe publikimit të artikujve së bashku me [13 pedagogë](#) të trajnuar në [13 universitetet e Tiranës dhe Durrësit](#). Universitetet më të mëdha përjetuan ringjalljen e një kulture debati të munguar në auditorët universitare duke vënë theksin tek aftësitë kërkuese, analizuese dhe komunikuese të studentëve. Projekti i dha hapësirë dhe peshë perspektivave dhe zërave të studentëve si instrumente fuqizues të rinisë. Ndërkohë, në përfitim të shoqërisë, projekti përmirësoi [debatin publik](#) mbi Integrimin European duke mundësuar rini të mirë-informuar dhe të angazhuar lidhur me ndikimin shumë-dimensional të integritit në vend, por [edhe më gjerë në Europë](#) si edhe duke nxitur studentët të reflektojnë rreth sfidave aktuale të shoqërisë shqiptare si pasojë e COVID-19.

Projekti u zhvillua në dy faza: *Faza e parë* përkoi me [Trajnimin e 13 Trajnerëve](#) (mentorëve) lidhur me formatin dhe strukturën e debatit Dhjetor 2019 – Shkurt 2020. Trajnimet janë fokusuar në formatin dhe tematikën e debatit. U prezantua [formati i debatit](#) si një ndërthurje midis Cross-Examination and Karl Popper duke i ofruar studentëve mundësinë të përdorin analizë kritike dhe logjikë të fortë pro dhe kundra për tematika me rëndësi. [Tematikat](#) dhe [paketa kërkimore](#) u përgatitën me një [proces të hapur dhe me pjesëmarrjen](#) e 13 mentorëve dhe sugjerime nga ekspertë të fushës të rrjetit SCiDEV, studentët dhe OSFA. *Faza e dytë* ishte ajo e përgatitjes së skuadrave dhe debateve në 13 fakultetet përkatëse. Në kushtet e pandemisë COVID-19, me qëllim që të përgatiteshin për mundësinë e zhvillimit të debateve online dhe për të marrë mendimet e studentëve dhe pedagogëve në mënyrë të strukturuar, SCiDEV ndërmori një [pyetësor](#) për të vlerësuar kapacitetet dhe mundësitë e studentëve pjesëmarrës për të arritur rezultatet e projektit online. [Gjetjet e pyetësorit](#) shërbyen për të informuar vendimmarrjen e SCiDEV lidhur me realizimin e debateve online. SCiDEV publikoi një [raport të plotë](#) lidhur me analizën e gjetjeve duke përfshirë edhe [rekomandimet përkatëse](#) për masat për të bërë të mundur përfundimin me sukses të projektit. SCiDEV realizoi përshtatjen e [formatit të debatit](#) dhe [paketës kërkimore](#) duke vendosur edhe burime për ndikimin e COVID-19. [Trajnimi](#) për formatin dhe tematikat e rishikuara të debatit u realizua online.

Finalizimi i projektit u zhvillua përmes debateve të strukturuar ([videot](#)) me 13 skuadrat pjesëmarrëse dhe me moderim të mentorëve dhe ekspertëve të SCiDEV. Përgatitja e të rinjve mbi temat e BE-së nuk përfundoi me debatin, por një hapësirë në formë [Blog](#) ju dedikua artikujve nga kërkues të rinj, studentëve të përfshirë dhe palëve të interesuara për të shkruar mbi këtë temë, duke shërbyer si fillesë për diskutime publike me analizë, evidenca dhe reflektime ndryshe nga qasja e deritanishme në Shqipëri. SCiDEV realizoi edhe një [botim të plotë përmbledhës të artikujve](#) për të dokumentuar perspektivat e të rinjve dhe për t'i ndarë ato me audiencën të tjera.

Studentët morrën pjesë aktive dhe prezantuan arritjet e tyre edhe në konferencën finale të projektit: [Debating Europe](#) me pjesëmarrjen e deputetëve të Parlamentit të Shqipërisë dhe Bullgarisë në bashkëpunim me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë ([Programi](#)). Në këtë event virtual, mentorja e projektit Dorina Gjipali prezantoi arritjet e projektit duke u ndaluar më shumë në [rolin e të rinjve në integrimin european](#). Gjithashtu studentët përgatitën një raport të ideve dhe argumenteve kryesorë gjatë debatit, mbi bazën e të



cilës SCiDEV ka hartuar një [dokument përmbledhës](#) me rekomandime për hapat e mëtejshëm. Për më tepër është publikuar edhe një [artikull blog](#) për arritjet e projektit dhe rekomandimet. Për më shumë informacion mbi realizimin e projektit mund të klikoni [këtu](#), dhe mund të ndiqni [videon prezantuese](#) dhe një [video përmblyëse](#).